



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 21.04.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.04.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Biohit MDS, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor”, me Nr. të Prok: 616-20-016-111
nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të Biohit MDS të dt. 17.04.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekëso me Nr.616-20-016-111, kundër *Njoftimit për kontrate* të AK-së, të datës 07.04.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Njoftimi për kontrate** i publikuar me datë: 07.04.2020 do të ndryshohet përmes Formularit standard për korrigjim i cili do të publikohen në platformën elektronike;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Biohit MDS me datë 17.04.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe**

mjekëso me Nr.616-20-016-111: Autoriteti Kontraktues, me datë 21.04.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sipas Nenit 7 LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS dhe sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Kosovës për evitimin e krijimit te monopolit dhe mbytjen e konkurences, mendojme se kerkesa per te kerkuar autorizimin e prodhuesit ne kete forme shkel ne menyre flagrante kete nen dhe pikat e keti neni (me poshte shiko pershkrimin per secilen pike te ketij neni).

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi


OE pretendon se AK ka shkelur nenin 7 te LPP me kerkesen e kerkuar ne Dosje te Tenderit per Autorizim te prodhuesit.

Zyrtari pergjegjes i prokurimit pas shqyrtimit te lendes ne menyre qe te rris konkurrencen nxjerr vendim qe te hjek kerkesen per Autorizim te prodhuesit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit